



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME VLORE SH.A

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më __ / __ / 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Pune Publike

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Supervizion punimesh për objektin: “Ndërtim I Rrjetit të Kanalizimeve nga Lungomare deri në hyrje të Radhimës, Vlorë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45247130-0 punime ndertimi për ujësjetlës

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,897,762 (tre milion e teteqind e nentedhjete e shtate mije e shtateqind e gjashtedhjete e dy) leke pa TVSH

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Shoqëria Rajonale Ujësjetlës-Kanalizime Vlorë**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021 ,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se fondit limit te kontrates qe po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure eshte "E Hapur e Thjeshtuar Shërbime", percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit dhe ne procedurat e prokurimit E Hapur e Thjeshtuar Shërbime si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit 2021 , 2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të

dorezojë:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës së fondit limit që prokurohet , të realizuara gjatë tri viteve tëfundit, nga data e njoftimit të kontratës së shpallur si me poshte :

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate, formular dorëzimi dhe akt kolaudimi të objektit.
- b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e mbikqyrjes dhe faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.1. Liçenca profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikeqyrje dhe Kolaudim punimesh zbatimi ku të përfshihen kategorite:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP-1 Punime gërmimi në tokë.
- NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.
- NP-3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
- NP-7 a. Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.
- NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS - 1 Punime për prishjen e ndërtesave
- NS - 8 Struktura metalike
- NS - 9 Punime struktura speciale
- NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- NS - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- NS- 17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
- NS - 18 Punime topogjeodezike
- NS-19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.
- NS – 20 Shpime gjeologo-inxhinierike
- NS – 21 Impiante të trajtimit të ujrave të zeza

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, qëparashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Meqenese kemi te bejme me Mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se Kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit per Objektivin ne fjalë

2.3.2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknikë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeolog 1 (nje)
- Inxhinier Mjedis 1 (nje)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune noteriale, Diplomën Universitare, Cv, dhe Certifikimin përkatës si dhe te figurojne ne listepagesen e shoqërisë per periudhen e kerkuar 3 (tre) muajt e fundit .

Argumentimi:

Inxhinier Ndërtimi 1 (nje), sipas zerave te Punimeve ne preventivin e zbatimit te punimeve, kerkohet te pakten nje inxhinier Ndertimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve civile që do të bëhen për objektin. Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve lidhur me zërat e preventivit dhe kontrollin e tyre.

Inxhinier Gjeodet 1 (një), gjithë puna eshte e bazuar ne volume germimi, saktesi ne matje, te cilat do te duhet ti mbuloje nje inxhinier Gjeodet, Drejtues Teknik i shoqerise ofertuese, i cili është përgjegjës për kontrollin e pikezimeve të germimeve për realizimin e hapjes së kanaleve, themeleve si dhe sistemimet topografike që nga fillimi i punimeve deri në përfundimin e tyre.

Inxhinier Hidroteknik 1 (nje), Konkretisht, është kërkuar të ketë në staf Inxhinier Hidroteknik i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike që do të bëhen për objektin.

Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike lidhur me zërat e preventivit të punimeve dhe kontrollin e të gjitha punimeve të sipercituara, duke ruajtur kuotat dhe vizën pjezometrike të tubacioneve.

Inxhinier Elektrik 1 (nje), gjithë gjurma e objektit kalon neper qendrat e banuara, në pjesët anesore pergjate infrastruktures ekzistuese, te cilat kanë nderthurje me linjat dhe kabinat elektrike te zones. Prezenca e Inxhinierit elektrik, pergjegjes per mbikqyrjen e punimeve elektrike, do te jete kushtezyese per vazhdimesine e punimeve te objektit.

Inxhinier Elektroteknik 1 (nje), Lidhur me punimet elektromekanike të objektit, nisur qe nga llojet e pompave dhe psjiseve te perdorura te cilët do të kryejnë shndërrimin e energjisë elektrike ne mekanike eshte kusht i domosdoshem për mbikqyrjen e saktë për pajisjet e vendosura në objekt sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike.

Inxhinier Gjeolog 1 (nje), Objekti bazohet ne germime per hapjen e kanaleve te ujerave te Ndotura, pergjate nje gjurme te konsiderueshme, e cila do te kete nevojte per studimin e shtresave te tokes, duke qene se punimet jane ne afersi te rruges ekzistuese dhe te qendrave te banuara, per te shmangur çdo incident të mundshem në degradimin e shtresave te tokes.

Inxhinier Mjedis 1 (nje), ashtu si u permend edhe me sipër, punimet jane ne qender te banuar dhe prezenca e nje inxhinieri mjedisi kerkohet me qellim shmangien e ndotjeve mjedisore nga prania e dherave ne rruge, germimeve, si edhe ndotjes akustike qe mund te shkaktojne mjetet prezente në Objekt dhe në rrugë.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin ndihmes ne listëpagesa si më poshtë::

- Një Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier i pajisur me Certificate për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2024- Gusht 2024

- 1 (nje) Inxhinier i pajisur me Diplome për Menaxhim Projektesh . Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2024- Gusht 2024
- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
- Një inxhinier te certifikuar me certifikatë “Kontrollor Cilësie”
- Një inxhinier të certifikuar me certifikatë “Kontrollor Volumesh”
- Nje punonjës të specilizuar në ruajtjes së shëndetit dhe të sigurisë në Punë (HSE)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Cv, dhe Certifikimin përkatës si dhe te figurojne ne listepagesen e shoqërisë per periudhen e kerkuar 3 (tre) muajt e fundit .

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Argumentimi:

(Nje) inxhinier Gjeodet, do te jete ndihmes per Drejtuesin Teknik Gjeodet, per shkak te volumeve te larta te punimeve ne germim, si dhe sistemimet topografike që nga fillimi i punimeve deri në përfundimin e tyre.

1 (nje) Inxhinier i pajisur me Certifikate për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2024- Gusht 2024. Ky kriter vjen si rezultat i punimeve ne nje qender te banuar, me kohezgjatje punimesh relativisht te larte dhe Vleresimi I Ndikimit ne Mjedis do te ofroje mundesine e sigurimit te mbrojtjes se larte te mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem, permes perfshirjes se ceshtjeve te mjedisit me pasoja sa me minimale te mundshme negative ne mjedis.

1 (nje) Inxhinier i pajisur me Diplome për Menaxhim Projektesh . Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Qershor 2024- Gusht 2024. Menyra e menaxhimit te projekteve nga specialiste te fushes ne rastet kur projektet perfshijne disa kushte si kohezgjatja e punimeve, demtimet ne infrastrukturen ekistuese, devijimi i trafikut, kerkojne nje metodologji te caktuar punimesh per menaxhimin e punes sipas grafikut, pa cenuar tejet normave te lejuara jeten e kalimtareve, udhetareve apo banoreve te zones.

1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Ky ekspert është i domosdoshëm për të evituar ndodhjen e cdo situatë të paparashikuar si dhe mbrojtjen nga zjarri.

Një inxhinier të certifikuar me certifikatë “Kontrollor Cilësie”. Ky kriter vendoset me qëllim garantimin e cilësisë së punimeve, duke përfshirë materialet e perzgjedhura sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga projektuesi, si dhe cilësisë së punimeve të kryera nga sipërmarrësi i punimeve përgjatë gjithë kohezgjatjes su punimeve deri në plotësimin e kushteve të kontratës.

Një inxhinier të certifikuar me certifikatë “Kontrollor Volumesh”, i cili do te jetë përgjegjës për kontrollin e sasisë së volumeve të ndërtimit, për të gjithë zërat e preventivit, kryesisht në punimet e germimit, trasimet dhe tubacioneve të Objektivit ne fjalë.

Nje punonjës të specilizuar në ruajtjes së shëndetit dhe të sigurisë në Punë (HSE). Kjo kërkesë mbështetet në

ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "**Për sigurinë dhe shëndetin në punë**" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

1.3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 20 (njëzetë) persona.. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për 3 (tre) muajt e fundit.
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajt e fundit

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe menaxhimit e sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 14001-2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose, ose ekuivalentet
- ISO 39001:2012 (Sistemi i Menaxhimit Të Trafikut Rrugor) - ose ekuivalent

Argumentimi: *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

Çertifikatë ISO 9001 - 2015 *“Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.*

Çertifikatë ISO 14001-2015 *“Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kerkohet pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit eshte nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi, kurse metoda me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombetar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 eshte bere, pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në veper duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.*

Çertifikatë ISO 45001-2018 *“Per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune” mundëson qe çdo shoqeri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.*

Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet

me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye,

Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetin gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

Çertifikatë ISO 39001-2012 “Për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në Trafikun Rrugor” kërkohet që Operatori Ekonomik të cilit do t’i jepet kontratë të ketë besueshmërinë e nevojshme në menaxhimin e situatave që do të krijohen gjatë punimeve që do të kryhen në këtë vepër. Kjo certifikatë mundëson që shoqëritë të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e eventualiteteve, humbjes së jetës apo plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

Zona ku do kryhen punimet është pjesë e zonës urbane dhe si e tillë është pranë një infrastrukture ekzistuese rrugore e cila do t’i shërbejë edhe zbatimit të kësaj veprë. Në këto kushte lind nevoja e disponimit të kësaj certifikate.

2.3.6 Operatorët ekonomike duhet të kenë pajisjet dhe mjetet si më poshtë:

- Gps 2 cope;
- Total station 2 cope;
- Dron për matje topografike 2 cope

a) Për pajisjet operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh: Fature tatimore të shitblerjes, kontratë shitblerje ose kontratë qiraje të noterizuar.

Shënim: Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit.

Argumentimi : Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë dhe kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të realizuar shërbimin. Droni, Gps dhe total station duhet të kontrollohen matjet topografike dhe punën në terren, pasi vepra është kanalizim i shtrirë në një sipërfaqe të konsiderueshme, dhe duhet të ndertohej duke repektuar kuotat e dhëna nga projektuesi në projekt.

Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë për përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike.

Gjithashtu, Administratori i shoqërisë duhet të paraqesë deklaratë për mosangazhimin e inxhinierëve pranë pranë autoritetit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave të referencës • Termat e Referencës

- Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar nga specialist të fushës në bazë të V.K.M nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim"., dhe janë marrë në konsideratë të tjerë elementet përberës të shërbimeve të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës.

Njesia e Prokurimit